

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT**



PUNIMI I DIPLOMËS – MASTER

**MIRËMBAJTJA DHE RREGULLIMI I SKIVE SI MASË E
PARANDALIMIT TË LËNDIMEVE**

MENTORI:
Prof. Dr.Bujar Turjaka

KANDIDATI:
Agron Misini

Prishtinë, 2015

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	3
2. QËLLIMI I PUNIMIT	7
3. METODAT E PUNËS	8
4. FAKTORËT E LËNDIMEVE GJATË SKIJIMIT	9
4.1. PËRGATITJA FIZIKE	10
4.1.1. Zhvillimi i shpejtësisë	11
4.1.2. Zhvillimi i forcës.....	12
4.1.3. Zhvillimi i qëndrueshmërisë	14
4.1.4. Zhvillimi i koordinimit	15
4.1.5. Zhvillimi i qëndrueshmërisë	16
4.2. TEKNIKA E DOBËT E SKIJIMIT	17
4.3. SHPEJTËSIA E SKIJIMIT	23
4.4. DUKSHMËRIA E ULËT GJATË SKIJIMIT	24
4.5. BORA E FORTË OSE AKULLI NË SHTEG.....	26
5. PAJISJET E SKIJIMIT	27
6. SKITË	28
6.1. LLOJET E SKIVE	28
6.2. MIRËMBAJTJA E SKIVE.....	31
6.3. KËPUCËT PËR SKI.....	36
6.4. LIDHËSET E SKIVE	39
6.5. SHKOPINJËT E SKIJIMIT.....	42
6.5. DORËZAT E SKIJIMIT	44
6.6. SYZAT E SKIJIMIT.....	45
6.7. KAPELA – HELMETA PËR SKIJIM	49
6.8. RROBAT PËR SKIJIM	52
7. PËRFUNDIMI	53
8. LITERATURA	55
REZYME	57
SUMMARY	58

1. HYRJE

Një ndër sportet që është shumë i adhuruar nga popullata e të gjitha moshave është sporti i skijimit. Sporti me ski është një ndër sportet më të hershem pasi që skitë janë përdorur si mjet për të ecur mbi borë për nevojat e popullatës për ekzistencë. Skijimi si mënyrë për të lëvizuar mbi borë mendohet të ketë prejardhjen nga vendet skandinavike para 4000 vjetësh dhe është paraqitur si nevojë e njerëzve për të siguruar ushqimin.

Skiatorët që dëshirojnë të vozisin ski duhet të kenë përgatitje dhe pajisje të skijimit në mënyrë që të ndihen më komot dhe të jenë më të sigurt gjatë vozitjes.

Në pajisjet e skijimit bëjnë pjesë:

- a) skitë
- b) këpucët për ski
- c) shkopinj të për tu mbajtur
- d) lidhëset
- e) dorezatë) kombinizoni(për erë, për mjegull)
- f) syzat për ski(për diell, për borë)
- g) kapela, etj.

Ndarja themelore e skiatorëve bëhet sipas angazhimit të tyre dhe ndahet në amatorë dhe profesionistë, pra, kështu që edhe ndarja e pajisjeve të skiatorëve ndahen në këtë mënyrë. Gjithashtu ekziston edhe ndarja e disiplinave të skijimit, kështu që nëse dikush dëshiron të vozit sllallom iu nevojiten ski më të shkurtra (me rreze më të vogël), për ata që preferojnë më shumë sllallomin e madh të marrin ski më të mëdha (me një rreze më të madhe). Për të gjitha skiatorët që merren në mënyrë rekreative të cilët nuk janë përcaktuar për disiplinën e skijimit, ekzistojnë të quajtura, universale, që janë të destinuara për të gjitha disiplinat.

Skijimi i rehatshëm dhe i lehtë kërkon përgatitje të duhur dhe mirëmbajtjen të skive, të cilat çdo skiator me vullnet pak më të mirë dhe aftësi mund ta bëjë këtë.

Për këtë duhet: dy shtrëngues përfiksimit të skive, kruajtësi metalike dhe plastike, shkopinj poliestër, letra gryese, hekurosesi e tjera.

Para daljes në dëborë, në ski duhet:

- të mprehen skajët e skive
- të pastrohen dhe lyehen sipërfaqet e rrëshqitshme
- të rregullohen lidhëset.

Që skijimi të jetë i sigurt dhe i rehatshëm, është e nevojshme që skit të përgatiten siç duhet. Para skijimit të parë rregullisht të mirëmbahen dhe në fund të sezonit konzervohen siç duhet. Shumë skiatorë duan të përgatisin, ruajnë dhe mirëmbajnë skit e tyre vetëm, por ka edhe të till që ti përgadisnin edhe në qendra të skijimit .

Skijimi si sport te skiatorët paraqet një ngarkesë të madhe psikike dhe fizike duke kërkuar nga skiatorët forcë të madhe, qëndrueshmëri, koordinim dhe agilitet, sepse te fituesit gjatë garës vendosin të qindat e sekondës.

Skijimi nuk është një sport që përbëhet vetëm nga disiplina e lëshimit poshtë shpatit, por gjithashtu përfshin kalimin e kthesave, ngjitjen, ramjet dhe ecjet në dëborë, gjatë së cilës përfshihen grupe të madh të muskujve, muskujt veçanërisht të këmbëve.

Skiatori duhet të dinë të shfrytëzojë në mënyrë racionale forcën, pa marrë parasysh shpejtësinë të cilën e arritin dhe në situata në të cilën ai ndodhet. Trajningu i skiatorëve është i fokusuar kryesisht në zhvillimin e aftësive motorike dhe funksionale të skiatorëve, si dhe në ruajtjen e nivelit maksimal të përgatitjes fizike para garës.

Trajnimi i skiatorëve ndërtohet mbi parimin e bashkëpunimit të trajnerëve me përvojën praktike të tyre, dhe ekspertëve hulumtues në fushën e mjekësisë sportive nga ana tjetër, dhe e projektuar në atë mënyrë që nivelet e lehta të ushtrimeve të lidhin nivele të ndërlikuara me rritjen e vazhdueshme të nivelit të ngarkesës.

Gjatë këtij procesi të ndërlikuar, vazhdimisht në mënyrë alternative ndërrohen periudhat e ngarkesave me periudha pushimi. Si dhe stresi me periudhat e përshtatjes në ngarkesa, dhe dinamika e këtyre ndryshimeve kontribuon në cilësinë dhe arritjen e rezultateve kulmore në skjim.

Se sa është i rëndësishëm skijimi në disponimin e njerëzve që aplikojnë skijimin tregon edhe studimi Studimi përfshiu 279 persona gjatë sezonit të skijimit. Ata plotësuan një pyetësor që përfshinte pyetje në lidhje me disponimin e tyre, ndjenjën e kënaqësisë dhe nivelin e aktivitetit fizik. 45 për qind e prej tyre merreshin me snoubord, 40 për qind me skijim dhe 15 për qind me të dyja aktivitetet.

Personat të cilët kishin më shumë avantazhe për shëndetin emocional, ishin ata që më së shumti kohë kalonin në skijim. " Aktiviteti fizik e sidomos aktiviteti fizik është po aq e rëndësishme për të rriturit sa është për fëmijët, duke shtuar se "lumturia kryesisht varet nga aktivitetet tona, dhe prandaj duhet t'i zgjedhim ato me kujdes" (Hyun-Woo Lee, 2009). Është interesante se rezultatet treguan që skijimi është më efektiv për mirëqenien emocionale se sa snoubordi dhe sportet tjera. Studimi ka treguar se aktiviteti fizik ka një fuqi çudibërëse në përmirësimin e disponimit, parandalimin e depresionit dhe forcimin e vetëbesimit, dhe ky hulumtim e vërteton këtë edhe një herë.

Duke e pasur parasysh këto se skijimi shton disponimin e njeriut për të sfiduar shpejtësit e kalimit të shtigjeve të mbuluara me borë dhe ekzekutimin e figurave të ndryshme gjatë skijimit, kujdesi duhet të jetë i madh duke filluar nga përgaditja kondicionale deri te mirëmbajtja e skive të cilat duhet të jenë të sigurt gjatë vozitjes.

Popullariteti i sportit të bardhë, si dhe rritja e numrit të turistëve të cilët vendosin për dimrime dhe të merren me disa nga aspektet e rekreacion në dëborë shpesh çojnë në aksidente dhe situata të pafavorshme në shpatet dhe shtigjet e skive. Respektimi i rregullave në shtigjet e skive kontribuon që keqkuptimet e ndryshme, si gjatë skijimit ashtu edhe prezenca në shteg, të reduktohen në minimum. Shpejtimi dhe egzibicionet të pa matura nëpër shteg me ski, si dhe pengimi i skiatorëve të tjerë mund të çojë në një shumëllojshmëri të lëndimeve, të cilat mund të jenë shumë të rënda dhe të dhimbshme si për vet skiatorët e pakujdesshëm ashtu edhe për të tjerët të cilët janë dhe gjenden në shtegun e skijimit.

Për shkak të kësaj, Federata Ndërkombëtare e Skitarisë (FIS) ka përcaktuar rregullat e trafikut dhe të sjelljes së përgjithshme në ski shtigje, të cilat duhet të ndiqen në mënyrë që të shmangen incidentet dhe të rregullojë rendin nëski shtigje.

Këto rregulla janë të përfshira në dhjetë pikë dhe kanë të bëjnë me rekomandime të përgjithshme për skijim të sigurt dhe argëtim të mirër në sportet e dimrit. këto rregulla janë:

1. Çdo skiator është i detyruar të veprojë në mënyrë që me vozitjet e tyre mos të rrezikoj dhe mos të lëndojë të tjetër.
2. Shpejtësinë dhe mënyrën e skijimit duhet të përshtatet me njohuritë dhe aftësitë që posedon skiatori, si dhe kushtet e motit dhe kushteve në ski-shtigje.

3. Nëse zbret nga maja e pistës ose shtegut, duhet të zgjidhni rrugën ose drejtimin që nuk e rrezikojnë ata që zbresin para jush.
4. Tejkalimi skiatorin tjetër lejohet nga ana e sipër dhe poshtëm, nga ana e majtë dhe e djathtë, por me distancë të mjaftueshme që skiatori tjetër të ketë hapësirë të skijoj.
5. Skiatori i cili ka për qëllim të kalojë shtegun tërthror ose për së gjeri (transversel) duhet të shikojë dhe të bindët që poshtë dhe lart nuk ka skiatorë që mund ti rrezikojë me kalimin e tij. E njëjta gjë vlenë për çdo ndalje ose pauzë në shtegun e skijimit.
6. Çdo vonesë dhe ndalje në pjesët e ngushta dhe të pa dukshme të pistës nuk lejohet pa pasur nevojë të ngutshme. Nëse skiatori ka ra, duhet larguar sa më shpejt të jetë e mundur nga ajo pjesë e pistës.
7. Nëse ngjitemi me ski shtekut atëherë duhet për skaj shtegut. Nëse shikimit është i dobët, të gjithë duhet të largohen nga pista gjatë ngjitjes. Kjo është gjithashtu vlen edhe për skiatorë që zbresin në këmbë.
8. Është detyrë e çdo skiatori të respektojnë shenjat e komunikacionit në pistat e skive. Shenjat e verdhë tregojnë rrezik. Shenjat që tregojnë rrugën në këmbë janë blu, ngjyrë e kuqe apo e zezë, në varësi të faktit nëse pista është ilehtë, e mesme ose e rënda.
9. Nëse ndonjë skiator lëmdohet në shteg, detyrë e çdo njërit apo skiatori që e gjenë dhe e shef menjëherë të ndihmojë dhe të informojë shërbimin specialistik .
10. Kushdo që është dëshmitar apo pjesëmarrës në një aksident në pistë, pa marrë parasysh a e ka shkaktuar atë apo jo, është i obliguar që me kërkesë të autoritetit kompetent të tregojnë letërnjoftimin ose një dokument të vlefshëm identifikimi.

2. QËLLIMI I PUNIMIT

Çdo person, para se të shkojë në skijim dihet të vërtetojë se përgaditja e tij për skijim a është adekuate duke filluar nga: skitë, këpucët për ski, shkopinjë për tu mbajtur, lidhëset, dorezat, kombinizoni (për erë, për mjegull), syzat për ski (për diell, për borë), kapela, etj. Nëse njëra nga këto përgaditje nuk është adekuate shtohet rreziku nga lëndimet trupore. Por nga këto pajisje, mirëmbajtja e skive kërkon kujdes të veçant sepse nga skit varet edhe siguria e rrëshqitjes.

Qëllimi i këtij punimi është që të tregohet mënyra e mirëmbajtjes së skive dhe përgaditjeve të skijimit në mënyrë që të ndihemi më komod gjatë skijimit dhe të zvoglojmë mundësitë nga lëndimet.

Gjithashtu, në këtë hulumtim do të bëjmë përpjekje që të vërtetojmë rëndësinë e mirëmbajtjes së skive dhe përgaditjes përcjellëse në parandalimin e lëndimeve gjatë skijimit si dhe në bazë të shënimeve të gjertanishme të vërtetojmë cilët kanë qenë shkaktarët kryesor të lëndimeve në garat e skijimit.

3. METODAT E PUNËS

Cili do problem antropologjik është i mundur të operacionalizohet në shumë mënyra të ndryshme. Megjithatë, natyra e shumicës së problemeve dhe karakteristikave të proceseve shpesh kërkojnë një qasje multivariante. Sipas natyrës së kërkimit shkencor ky studim i përket kategorisë së kërkimeve teorike.

Metoda e cila do të aplikohen në këtë punim është metoda deskriptive dhe krahasuese.

4. FAKTORËT E LËNDIMEVE GJATË SKIJIMIT

Në shpatet e skijimit çdo vit, shkaktohen ose ndodhin një numër ti konsiderueshëm i lëndimeve. Jo aq të rralla, këto lëndime kërkojnë trajtim serioz. Në vitet e fundit, numri i këtyre lëndimeve është në rënie, por po ndryshohjet karakteri i lëndimit. Dikur ishin lëndimet më të shpeshta të zohut të këmbës ose nëngjurit, tani ato janë lëndime të gjurit dhe lëndimet e ekstremiteteve të sipërme (të gishtit të madh dhe shpatullat). Reduktimi i frekuencës së lëndimeve mund ti përshkruhet së pari pajisjeve më të mira si dhe përmirësimit të cilësisë së shtigjeve të skijimit.

Shfaqja e lëndimit gjatë skijimit varet nga disa faktorë: pajisjet, aftësitë dhe shkathtësitë e skijimit (dhe e rënies ose rrëzuarjes) dhe vlerësimi i aftësive të tyre. Gjithashtu me rëndësi janë kushtet e motit, si dhe cilësia e pistës.

Shkaqet e lëndimeve në pistat e skijimit janë:

1. Përgatitja fizike
2. Teknika e dobët e skijimit
3. Shpejtësia e skijimit
4. Dukshmëria e ulët
5. Bora e fort ose akulli
6. Veshmbathja (pajisjet) për skijim

4.1. PËRGATITJA FIZIKE

Që të argëtohem sa më mirë në të dëborë dhe që të kalojmë kohën sa më mirë gjatë pushimeve dimrore, kërkon përgatitje të mirë dhe njohuri të rregullave të sjelljes dhe mbrojtje në shtigjet e skive. Vetëm kështu mund ti ju shmangemi lëndimeve, të cilat janë shumë të shpeshta si pasojë e papërgatitjes dhe mungesës së njohurive të disa prej rregullave të përgjithshme të pushimeve aktive në dëborë. Këtu ne duhet të specifikojmë situatat të caktuara të rrezikut që janë shkakar më të shpesht të lëndimeve të skiatorë.

Skijimi është një aktivitet fizik që aktivizon të gjitha grupet e muskujve, dhe madje edhe disa muskuj që zakonisht nuk janë aktive; zhvillohet në lartësi të larta mbidetare; janë luhatjet e mëdha të temperaturës; Muskujt ftohen relativisht shpejtë gjatë pushimit, ose gjatë udhëtimit në teleferik, dhe pastaj përsëri nxehen gjatë skijimit; ekspozimi i madh ndaj diellit dhe rrezet ultravijole (UV).

Prandaj, përgatitjet për ski duhet të fillojnë në aspektin optimal tre muaj më parë. Këto përfshijnë këshilla të ekspertëve, testimin dhe kontrollimin, gjendjen e trupit, si dhe verifikimin e grupeve të caktuara të muskujve dhe nyjeve, pastaj kontrollin e sëmundjeve kronike, dhe të zbatojmë ushtrime të veçanta për të përgatitur dhe për tu mbrojtur kundër lëndimeve të mundshme. Me rastin e përgatitjes për ski zakonisht kujdesi më i madh i jepet pajisjeve, skive, lidhseve, këpucve dhe rroba, ndërsa pak ose aspak vëmendje nuk i kushtohet përgatitjes fizike. Nëse nuk i kushtohet vëmendje e mjaftueshme përgatitjes fizike për skijim, periudha minimale për të filluar përgatitjen për skijim, koha më e skurtër është shtatë ditë para nisjes në skijim.

4.1.1. Zhvillimi i shpejtësisë

Është e qartë se shpejtësia si aftësi motorike ka rëndësi dominuese në të gjitha sportet njashu edhe në sportin e basketbollit. Në specifikimet lineare, sipas shumë ekspertëve të kësaj lëmie, kontributi ishpejtësisë në rezultatin e përgjithshëm është 30%.

Në harmoni me këtë, shpejtësi duhet të zënë një vend të rëndësishëm në procesin stërvitor në lojëne basketbollit.

Kur ne flasim për shpejtësinë në kontekst të skijimit, ne nuk duhet absolutisht të përqëndrohet vetëm në shpejtësinë e drejtimit të drejtë, sepse është vetëm një aspekt i zhvillimit të shpejtësisë në këtë sport. Është jashtëzakonisht e rëndësishme për sukses përfundimtar që në zhvillimin e shpejtësisë të përdorni lëvizje të shpejtësisë që janë karakteristike për skiatorët.

Shumica e ekspertëve sportive bien dakord se shpejtësia është e një rëndësie të madhe për suksesin nëskijim. Mund të vërehet se në shumicën e literaturave që kanë të bëjnë me stërvitjen sportive, si rregull i kushtojnë më pak vëmendje se sa qëndrueshmërisë dhe forcës. Arsytet për këtë me siguri qëndron në literaturën e paktë të hulumtuar dhe strukturën komplekse të shpejtësisë krahasuar me aftësitë e tjera kondicionale. Definicionin më të mirë të shpejtësisë e ka dhënë Freyova (1977) sipas të cilit shpejtësia është aftësi e sportistit që në bazë të efikasitetit të sistemit neuro-muskular të ekzekutojë lëvizje në një interval sa më të shkurtër kohorë. Disa ekspert botëror të skitarisë nga fusha e teorisë stërvitore (Dintiman, Ward i Tellez, 1997.; Brown, Ferrigno i Santana 2000.) theksojnë këto lloje të shpejtësisë:

- shpejtësia e reaktionit,
- shpejtësia startuese,
- shpejtësia e ndaljes,
- shpejtësia maksimale
- qëndrueshmëria në shpejtësi

Agjiliteti mund të përkufizohet si aftësi e shpejtësisë dhe efikasitetit të çvendosjes të trupit në hapësirë në kushte të papritur të ndaljes së shpejt dhe ndryshimit të drejtimit të lëvizjes. Ushtrimet e agjilitetit aplikohen më së tepërmi në proceset stërvitore në skijim.

4.1.2. Zhvillimi i forcës

Në hulumtimet e gjertanishme të aftësive motorike është argumentuar jo vetëm ekzistimi i forcës si dimension i hapësirës motorike por është vërtetuar dhe konstatuar mendimi se forca është ndër aftësitë themelore, e cila është vendimtare për funksionim efikas të sistemit të njeriut dhe kryerjen e operacioneve të ndryshme motorike si dhe identifikimin e somatotipit. Nuk ekziston, në të vërtet, asnjë akt motorik i cili të paktën pjesërisht nuk varët nga forca, çka është njohuri e rëndësishme për programimin e suksesit në cilën do aktivitet kineziologjik. Hulumtimet e gjertanishme të orientuara rreth njohjes sa ma të mire të hapësirës motorike kanë quar deri tek identifikimi i këtyre faktorëve aksional dhe topologjik të forcës:

- | | |
|--------------------------------|----------------------------------|
| 1. Faktorët aksional të forcës | 2. Faktorët tipologjik të forcës |
| - forca eksploziv | - forca e duarve dhe kraharorit |
| - forca statike | - forca e trupit |
| - forca repetitive | - forca e këmbëve |

Forca është aftësi motorike, e cila është ndoshta më i studiuara dhe pa forcë nuk mundet të ekzekutohet asnjë aktivitet motorik. Forca është përcaktuar si aftësi e njeriut që përmes tendosjes ose kontrahimit të muskujve përballon rezistencën e jashtme.

Programet themelore dhe më të shpeshta sa i përket rritjes së forcës në skitari janë :

1. Programi për i zhvillimin e forcës maksimale,
2. Programet për zhvillimin e forcë eksplozive,
3. Programet për zhvillimin e masës së muskujve (hypertrophy)
4. Programet për zhvillimin e qëndrueshmërisë së forcës muskulore.

Forca eksplozive

Forca eksplozive zakonisht përkufizohet si aftësi maksimale i akumulimit të energjisë në një lëvizje për një kohë të shkurtër. Ky faktor është i shprehur në të gjitha lëvizjet në të cilat i gjithë trupi ose pjesët e tyre, vazhdojnë lëvizjet e tyre për shkak të momentit të fituara, si dhe përsheptimin fillestar.

- Forca shpërthyesë nga aspektet fiziologjike varet kryesisht nga:
- Intensiteti impulzivitetit e korës së trurit të madh,
- Përshkueshmërisë së sinapsave motorike, shpejtësia e transmetimit të impulseve nga qendra drejt periferisë të efektorët,
- Numri i njësive motorike aktive,
- Gjendja biokimike e muskujve,
- Karakteristikat biomekanike të lëvizjes (gjatësia e leves, amplituda e lëvizjes)
- Shkalla e tensionit të grupeve të muskujve të caktuara
- Bashkëveprimi i këtyre grupeve

4.1.3. Zhvillimi i qëndrueshmërisë

Qëndrueshmëria është aftësia për të kryer aktivitete të caktuara për një kohë të gjatë pa u zvogëluar efektshmërinë e saj. Matës i qëndrueshmërisë është koha gjatë së cilës basketbollisti është në gjendje të mbajë intensitetin e caktuar të punës. Sot ekziston një numër i madh i ndarjeve në bazë të kriterëve të ndryshme. Lidhur me veprimtarinë e mekanizmave të performancës së energjisë qëndrueshmëria ndahet në:

1. Aerobe - energjia është siguruar nga proceset oxidative në prani të oksigjenit,
2. Anaerobe – energjia e përdoret është e siguruar nga proceset anoksidative pa praninë e oksigjenit, ku mund të dallojmë dy mënyra reciprokisht të ndryshme të marrjes së energjisë:
 - Prodhimi i energjisë anaerobe me prodhim të laktateve, ku energjia fitohet nga glikoliza anaerobe dhe quhet acidi laktik ose glikolitik.
 - Energjia anaerobe pa prodhimin e laktateve (acidi laktik), në mënyrë që energjia është fituar nga adenosine tre-fosfat (ATP) dhe kreatinë-fosfati (CP). Kjo formë e fitimit të energjisë quhet ndryshe edhe alaktat ose fosfagen.

Ushtrimet e qëndrueshmërisë çojnë në ndryshime në sistemet e organeve të ndryshme. Për këte esencialisht dallohet ndikimi në sistemet e organeve e ushtrimeve anaerobe në raport me ushtrimet aerobe.

Zhvillimi i kapacitetit anaerob çon në rritjen e deposë së energjisë të kreatinfosfatit dhe deposë glikolitike dhe në rritjen e aftësive të muskujve që të kryen punë në një gjendje të dalur nga homeostaza.

Punë e tillë shkakton ndryshime në sistemin kardiovaskular dhe ndryshime periferike në muskuj. Qëndrueshmëria anaerobe nënkupton aktivitetin me intensitet të lartë dhe kështu është shumë e vështirë dhe nuk mund të zbatohet në rekreacion, por vetëm në sport.

Ushtrimet aerobe kanë efekte pozitive në sistemin kardiovaskular (rritjen e muskullit të zemrës, rritjen e vëllimit goditës dhe minutor kardiak, në rritjen e kapacitetit vital, zvoglimin e pulsit në qetësi, rritja e përgjithshme të sasisë së gjakut, etj) dhe zbatimi i tyre në rekreacion është i madh.

4.1.4. Zhvillimi i koordinimit

Koordinimi është aftësia për të përmbushur detyrat e lëvizjes të cilat kërkojnë bashkëpunim të disa pjesëve të trupit pa tensione apo gabime mendore dhe me përpjekje minimale (Drabik, 1996). Koordinimi mund të përshkruhet më lehtë si aftësia për të kryer lëvizje të thjeshta dhe komplekse, pra aftësi e kryerjes së lëvizjeve të ndërlikuara, pra edhe të mësuarit e shpejtë të lëvizjeve të reja dhe ndrimi i shpejt i lëvizjeve nga njëra-tjetra (Drabik, 1996).

Mbi strukturën e koordinimit janë kryer mjaft studime (Metikoš et al, 2003; Neljak dhe Vishkoviç, 2004.) Në të cilat është konstatuar se koordinimi është i përbërë nga komponentet në vijim: ritmi, ekuilibri, aftësia e reagimit, diferencimi aftësia kinestetike, orientimi në hapësirë, mjaftueshmëria e lëvizjes dhe sinkronizimi i lëvizjeve në kohë (Drabik, 1996). Skema 3.

Struktura e koordinimit (Drabik, 1996).

Ndieshmëria në ritëm	Ekuilibri		Reakcioni
Diferencimi kinestetik	Orijentimi në hapësirë	Lëvizja adekuate	Sinkronizimi i lëvizjes në kohë

4.1.5. Zhvillimi i qëndrueshmërisë

Lëvizshmëria - fleksibiliteti, (aftësi fizike për egzekutimin e lëvizjeve me amplitudë sa më të mëdhe në nyje).

Është një nga aftësit themelore, të cilat ndikojnë në statikën dhe dinamikën e trupit, me këtë ndikojnë edhe në vetë aftësinë skijuese. Ushtrimet e regullta të fleksibilitetit zvogëlojnë ngarkesën e muskujve, risin lëvizshmërinë dhe mbrojnë qendrat e nyjeve. Kujdes të veçantë duhet të kushtohet ekstremiteteve të poshtme të cilat janë më aktive gjatë skijimit, por nuk guxojmë ti harojmë edhe muskujt tjerë. Ushtrimet e zgjatjes duhet të bëhen së pari në fillim dhe gjithësesi dhe në fund të aktivitetit, kur muskujt janë të shtangur dhe të lodhur nga puna. Me këtë zvogëlohet ngarkesa dhe arihet përmirsim më i shpejt i muskujve. Në fazën përgatitore, gjegjësisht në fillimin e aktivitetit trupor ushtrimet e zgjatjes bëhen pas nxemjes, me qëllim të ritjes së lëvizjes të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në egzekutimin e lëvizjeve në basketboll.

Të gjitha sportet kërkojnë një rang të mirë të fleksibilitetit, jo vetëm për shkak të përformimit të shfaqjes, por gjithashtu të parandalojnë ndonjë lëndim të mundshëm. Prej këndvështrimit të performancës, elasticiteti në çdo aspekt i jep basketbollistit mundësi të aplikimit të stileve të ndryshme manovruese.

Elasticiteti me forcën është një fushë efikase për të gjithë basketbollistët, dhe fleksibiliteti është përgjegjës nëse keqësohet trainingu i fortësisë, ushtrimet duhet të jenë të vazhdueshme dhe frekuentale (çdo ditë nëse është e mundur).

Është e rëndësishme që zgjatja të bëhet menjëher para proceseve stërvitore dhe të qëndrosh fleksibil në përgjithësi gjatë gjithë orës së procesit stërvitor. Është e rëndësishme që të përsëritet kjo te mujskujt, që kjo ndikon në kontrahimin më të shpejtë të tyre, në krahasim më ata muskujt të pa zgjatur. Fleksibiliteti nuk zhvillohet vetëm nga ushtrimet e fleksibilitetit, mirpo edhe gjatë ekzekutimit të ushtrimeve tjera gjatë seneve stërvitore.

4.2. TEKNIKA E DOBËT E SKIJIMIT

Ndër shkaqet kryesore të lëndimeve gjatë skijimit është teknika e dobët e skijatorëve gjatë skijimit. Peandaj teknika e skijimit duhet me kohë të përvetësohet.

Procedurat metodologjike që zbatohen gjatë mësimet të skijimit janë procedura të ngjashme metodologjike që zbatohen për mësuarjen dhe zhvillimin e elementeve teknike në metodat e tjera mësimore sportive. Zgjedhja e metodave mësimore dhe aplikimi konseguent i tyre në faza të caktuara të arsimit dhe trajnimit, është një komponent i zakonshëm për të mësuar teknikat e duhura.

Gjatë mësuarjes së teknikave të skijimit alpin kryesisht përdoren dy metoda: prezantimi me gojë dhe demonstrimi.

Metoda verbale - „fjala e gjallë” e mësimit në procesin e mësimet të skijimit, si metodë e punës, ka rëndësi dhe vlerë të madhe, sepse mundëson që skiatori fillestar – fëmijët ta krijojnë përfytyrimin e drejtë dhe të menjëhershëm mbi lëvizjen gjatë të mësuarit të lëvizjes, kuptohet si ushtrim trupor që duhet të ekzekutohet nga ana e skiatorit fillestar. „Fjala e gjallë”, aplikohet para se të filloj të ushtruarit, gjatë të ushtruarit dhe pas përfundimit të të ushtruarit .

Foto 1. Metoda verbale gjatë kursit të skijimit



Që të arrihet efekti i „fjalës së gjallë”, si nga aspekti arsimor, ashtu edhe edukativ, mësimdhënësi duhet t’i njohë faktorët, të cilët i klasifikojmë i klasifikojmë në :

1.Faktorë subjektiv

a) mësimdhënësi i cili duhet të ketë :

- aftësi të përgjithshme profesionale,
- qëndrimi personal ndaj vlerës së „ fjalës së gjallë ”,
- gjindshmëri profesionale dhe gjuhësore,
- aftësi të të shprehurit që të tjerëve t’u prezentohet – sqarohet mendimi , saktësia dhe udhëzimet mbi lëvizjet – ushtrimet.

b) fëmija, skiatori fillestar:

- moshë madhore,
- qëndrimi ndaj orëve të mësimt,
- karakteristikat e përgjithshme pedagogjike tëskiatorit fillestar,
- aftësia e skiatorit fillestar. për të ushtruar,

2.Faktorët objektiv

- lloji i teknikës,
- tipi i përgjithshëm i orës (ç’ dëshirohet):a rsimimi formues, puna në zhvillimin e aftësive lëvizore motorike.

Efekti dhe sukcesi i „fjalës së gjallë” varet nga aftësia e instruktori i skijimit se në ç’ nivel di ta bëjë interesante prezentimin – sqarimin dhe t’i motivojë nxënësit-fëmijët për punë.

Këtë e arrin nëpërmes:

- lajmërimit, paraqitjes së tezave,
- arsyetimit sistematik të problemit, ushtrimit (monolog i mësimdhënësit),
- vërejtjes, shpjegimit dhe komentimit,
- kontrollimit verbal të problemit të parashtruar dhe dialogu ndërmjet mësimdhënësit dhe nxënësit.

Shprehja e bukur dhe funksionale sipas natyrës dhe terminologjisë së lëvizjes, rezultatet bashkëkohore metodike bëjnë të mundur që „fjala e gjallë” të aplikohet në formë:

- ▶ Shpjegimi,
- ▶ Tregimi – kallëzimi,
- ▶ Urdhërimi,
- ▶ Numërimi,
- ▶ Biseda,
- ▶ Udhëzimi, komentimi etj.

Metoda e demonstrimit – paraqitja praktike në edukimin trupor kuptohet si demonstrim, që në aspektin profesional dhe shkencor konsiderohet ndër metodat kryesore kur është fjala për përvetësimin e elementeve – lëvizjeve, ushtrimeve të reja.

Foto 1. Metoda demonstruese gjatë kursit të skijimit



Me anë të demonstrimit (paraqitjes praktike) sigurohet mënyra më e përshtatshme që skiatori fillestar – fëmijët të arrijnë deri te informatat, të cilat do të mundësojnë krijimin e përfytyrimit të drejtë mbi lëvizjen – ushtrimin (elementin), të cilin duhet të përpiqen ta ekzekutojnë dhe ta mësojnë (përvetësojnë).

Gjatë procesit mësimor në orën e skijimit instruktori është i obliguar që të siguroj demonstrimin e detyrave motorike (teknikave) .

Demonstrimin mund ta bëjë personalisht ai ose ndonjë nxënës i dalluar, të cilin mësimdhënësi e angazhon sipas rasteve dhe kërkesave mësimore.

Çdo demonstrimi i paraprin „fjala e gjallë” e mësimdhënësit, i cili e shpjegon duke tërhequr vëmendjen e skiatorit fillestar - fëmijëve në atë se ç’duhet dhe ç’dëshirohet të punohet e të mësohet (përvetësohet).

Demonstrimi i lëvizjeve – ushtrimeve duhet të ekzekutohet në atë mënyrë që, përafërsisht, të gjithë nxënësit – fëmijët të kenë mundësi që papengesë t’i vërejnë të gjitha elementet e lëvizjeve – ushtrimit si tërësi.

Në raste të veçanta demonstrimi i elementit mund të demonstrohet edhe anash, (shikimi i skiatorit fillestar – fëmijëve) dhe të zgjedhet më i përshtatshëm prej nga nxënësit do të vështrojnë më lehtë.

Aplikimi i mënyrës së të ushtruarit praktik gjatë procesit mësimor në ed.fizike ka për qëllim që nxënësi – fëmija të aftësohet që në mënyrë të pavarur t’i përdor në jetën praktike.

Nga aspekti metodiko – organizativ në procesin mësimor gjatë të ushtruarit praktik në edukatën fizike , zakonisht dominojnë këto metoda apo mënyra:

- ▶ metoda – mënyra sintetike (të ushtruarit e ushtrimit si tërësi),
- ▶ metoda – mënyra analitike (të ushtruarit e ushtrimit pjesë – pjesë),

Metoda – mënyra sintetike – në kursin e skijimit kur bëhet fjalë për metodën sintetike mendohet në mënyrën e të ushtruarit të detyrës motorike (teknikës) me qëllim që ajo si tërësi të ushtrohet dhe të përvetësohet .

Duke i analizuar përmbajtjet programore të përfshira në planprogramin e punës së përbashkët edukativo – arsimore për nxënës–fëmijë, sipas moshave madhore rrjedh se mënyra e punës (metoda sintetike) është mënyra më adekuate dhe më e përshtatshme që të aplikohet në procesin e të ushtruarit praktik të detyrës motorike me qëllim të përvetësimit dhe të përsosjes.

Foto 1. Metoda sintetike gjatë kursit të skijimit



Si metodë kjo i ka përparësitë dhe dobësitë e veta:

Përparësia e kësaj metode qëndron në faktin se ajo individit (nxënësit) ia mundëson që të ushtruarit e detyrës motorike ta bëjë sipas aftësive të veta.

Dobësitë e kësaj metode gjatë procesit të të ushtruarit të detyrës motorike mund të lajmërohen vështirësi gjatë fazës së parë kur tentohet që detyra – lëvizja të ushtrohet dhe të përvetësohet.

Këtë metodë duhet aplikuar sa më shpesh gjatë organizimit dhe zhvillimit të mësimin, me qëllim që të arrihet përsosja dhe perfeksionimii shprehisë motorike (gjatë orëve të përsëritjes).

Metoda – mënyra analitike – në procesin e ed.fizike, në disa raste kur paraqitet ndonjë vështirësi gjatë të ushtruarit sipas metodës sintetike, duhet të aplikohet metoda analitike.

Foto 1. Metoda analitike gjatë kursit të skijimit



Sipas kësaj metode të ushtruarit e njësisë mësimore bëhet sipas të ushtruarit - përvetësimit të njëpasnjëshëm të pjesëve përbërëse të njësisë mësimore, që janë të ndara, por që kanë lidhmëri logjike, me ç'rast mësimdhënësi duhet të ketë kujdes që mënyra e tillë e të ushtruarit të mos teprohet, ngase në vazhdim në të ushtruar paraqet pengesë të madhe për përvetësimin e njësisë si tërësi.

4.3. SHPEJTËSIA E SKIJIMIT

Shpejtësia e skijimit si dhe mospershtatja e shpejtësisë gjatë vozitjes është një shkatarrët e lëndimeve të rënda.

Foto 1. Shpejtësia gjatë skijimit



Foto 1. Pasojat e shpejtësisë gjatë skijimit



4.4. DUKSHMËRIA E ULËT GJATË SKIJIMIT

Një ndër shkaktarët e lëndimeve dhe që paraqet rrezikshmëri për skiatorët fillestar, por edhe për ata me pervojë është dukshmëria e ulët për shkak të mjegullës apo natën. Kjo bënë që mos të kemi një pasqyrë ma të mirë të shtegut gjatë skijimit. Mjegulla është avulli i ujit i kondensuar në shtresat përdhese të ajrit. Mjegulla, sipas marrëveshjes ndërkombëtare, është një turbullirë e tillë e ajrit, me rastin e së cilës objektet përreth mund të shihen vetëm në largësi prej 1 km. Mjegulla shënohet me shenjën.

Foto 1. Mjegulla si shkaktar e rrxuemjeve gjatë skijimit



Mjegull është mbetja pezull e pikave të vogla të ujit ku shikimi horizontal është nën 1 km. Mjegullima ka të bëjë me mbetjen pezull të pikave mikroskopike të ujit ose të berthamave të kondensimit. Shikimi është më i madh se 1 km. Aty ku ajri nuk është i pasur me berthama kondensimi (det i hapur ose racione polare) dalja e mjegullës nuk varet nga intensifikimi gradual i mjegullimit dhe vjen shpejt. Formazioni me lageshtirë 100% pak a shumë varet nga prezenca e berthamave të kondensimit nga lloji dhe përqendrimi i tyre. Për ndonjë motiv kushtet e lageshtirës temperaturës erës dhe fitojnë një komponent të fortë lokal. Proceset që vijnë në formimin e mjegullës janë ato që rrisin lageshtirën relative të ajrit deri sa të arrihet pika e ngopjes.

Disa procese jane ftohja dhe me pak avullimi. Ajri prane siperfaqes se tokes ftohet atehere kur duhet te bjere nxehtesia ne token me te ftohte. Rastiset ne dy rrethana

- a. Kur toka ftohet nga recatimi i tepert naten.
- b. Kur ajri me i ngrohhte leviz ne token e ftohte.

Foto 1. Mjegulla zvoglon dukshmërin gjatë skijimit



4.5. BORA E FORTË OSE AKULLI NË SHTEG

Një ndër shkaktarët e shpesht të lëndimeve të skiatorët fillestar, është shtegu i papershtatshëm për të borës së fortë dhe akullit në shtegun e skijimit. Kjo bënë që mos jemi të sigurt gjatë skijimit.

Foto 1. Bora e fort dhe akulli në shtegun e skijimit



Foto 1. Bora e fort dhe akulli pasojë e rrëzimeve gjatë vozitjes së skijave



5. PAJISJET E SKIJIMIT

Zgjedhja e e pajisjeve adekuate të skijimit dhe mirmbajta e tyre është brengë e çdo skiatori. Pajisjet joadekuate shpesh sjellin deri te lëndimet e ndryshme gjatë skijimit. Por së pari do të flasim për zgjedhjen adekuate të skive.

Pajisjet e skijimit janë:

- a) skitë
- b) këpucët për skiim
- c) shkopinjtë
- d) lidhëset
- e) dorezatë, kombinizoni (për erë, për mjegull)
- f) syzat për ski (për diell, për borë)
- g) kapela

6. SKITË

6.1. LLOJET E SKIVE

Që nga fundi i mijëvjeçarit të kaluar, kur filloi revolucion Carving deri në ditët e sotme, nga sezoni në sezon prodhohen modele të reja të skive, ndryshohet gjeometria e tyre, duke përdorur materiale të reja për prodhimin e tyre, shfaqen teknologji dhe emra të rinj të çuditshme, trendet po ndryshojnë, me një fjalë paraqitet një konfuzion. Në fund të viteve '90 ishte më e lehtë, flitej vetëm për tri lloje të skive: klasike, gjysmë karving (çfarëdo që është) dhe Carving.

Llojet e skive sipas përdorimit



Sot çdo prodhues i modeleve të skive i ka renditur në mënyrën e vet, dhe në përgjithësi mund të bëhet fjalë për kategori themelore të skive. Disa prodhues të tillë si K2 (foto lart) prezantoj terminologjinë e veta, por edhe janë emra të pranuar:

- Race
- Allround
- Allmountain
- Freeride
- Freestyle

Race ski - Garuesit vozisin ski të prodhuara posaçërisht për gara. Zakonisht quhen ose bartin emertimin RD R (Race Department) dhe nuk mund të sigurohen në mënyrë të lirë, por me porosi. Këto nuk janë Race, Racing RD ski. Skit "Race" janë ski që duken sikur skit RD (të cilat janë të porsosituar ose i dedikohen skiatorë që zotrojnë tekniken e skijimit në mënyrë perfekte dhe që janë skiatorë të shpejtësive të mëdha) vetëm në shtigje të rregulluara. Prodhuesit bëjnë përpjekje që skit RD të duken sa më të ngjashme si modele gara (dhe anasjelltas), kështu që shpesh mund të shihen skit kur garuesi përfundon garën ose në fund të garës skiatori ia jep anëtarit të ekipit të tyre, dhe nga ai merrë një palë ski të ngjashëm vetëm për reklamim para kamerës. Jeton nga shitja e skive që mund të blehen në dyqane, dhe kështu qëllimi i kësaj është të bëjnë përshtyqe që këto janë skit me të cilat është fituar medalja. Shpesh skit Race janë në vetvete një "teknologji" revolucionare e cila nuk përdoret në skit konkurrues ose garuese, dhe edhe pse edhe në njërat dhe në tjetrat është emertimi i "teknologjisë" së njejtë. Marketingu përcakton rregullat në çdo gjë. Skit "Race" zakonisht janë me beli prej 65-70mm dhe një rreze prej 11 deri 14mm për "slalom" dhe 14 deri 17mm për modele për "veleslalom" ose slalom të madh. Profili gjatësor është Camber.

Race skit



Allraund skit - Këto lloje të skive kryesisht kryesisht janë të rregulluara dhe të prodhuara për shtigje të rregulluara, për skiatorë fillestar dhe amator dhe për skiatorë shumë të mirë. Janë pak më të gjera se sa skitë për gara ("Race" skit) dhe të përdorshme edhe në shtigje të pjerrëta dhe të papershtatshme për fillestar si dhe për vozitje fluturuese jashta shtegut. Këto kategori janë më të zakonshme në qendrat e skijimit. Prej sezonit në sezonë modelet e këtyre kategorive marrin nga disa milimetra në gjerësi, në mënyrë që beli sot shkon prej 70-80mm, ndërsa rrezja duke filluar nga 13mm deri 18mm. Profili gjatësor është zakonisht "Camber" me ose pa "Early Rise".

Allraund skitë



Allmountain skit - Univerzale. Shumë të mira në të gjitha kushtet në shteg dhe jashtështegu. Prodohen në shumë variacione dhe panumërta si në gjeometri shtu edhe në ndërtim. Gjerësia e mesit sillet nga 80 në 95mm, dhe me një rreze prej 17 në mbi 20m. Profili gjatësor i skive është në mes dhe bishtin e skive “Camber”, dhe lartësia është “Rocker ili Early Rise”.

Allmountain skit



Freeride skit - Ski me fokus ose të dedikuara në vozitje në borë të thellë, dhe me më shumë ose më pak mund mund të voziten edhe në shteg të rregulluar dhe të vështirë. Gjerësia e mesit nga 95mm në 140mm. Rrezja e vogël në borë të thellë më shumë pengon se sa ka dobi, dhe se kryesisht me një rreze prej më shumë se 30m. Profili gjatësore zakonisht është “Rocker” në një shkallë më të madhe apo më të vogël me “camber” në mes të skive. Vetëm për skiatorë shumë përvojë.

Freeride skit



Freestyle skit - Ski për parkun & tub, dmth. Egzibicione për pjesë posaçërisht të rregulluara të zonave të skijimit për hedhje ose kërcime dhe pengesa. Punojnë ose funksionojnë si “Twin-Tip” “binjak ose dysh-tip”, dmth., me bisht të ngritur, me skaje ose buzë të shprehur, dhe shumë shpesh gjeometria e pjesës së përparme të skive është krejtësisht identike me gjeometrinë e pjesës së prapme (përshkak të vozitjes prapa). Të përdorshme për shtigje me konfiguracion të ndryshëm, dhe sipas karakteristikave dhe gjeometrisë të ngjashme me skit Allmountain.

Freestyle skit



6.2. MIRËMBAJTJA E SKIVE

